



# *Shkolla E Mesme*

## *(Dytësore e Gradës Së Dytë)*

**N**ë Itali çdo nxënës duhet të frekuentojë shkollën o formimin profesional deri në moshën 18 vjeç. Kjo e drejtë / detyrë është për të gjithë nxënësit e huaj , me dokumenta të rregullta ose jo, me ose pa leje qëndrimi.

Duhet të shkruhen në shkollën e mesme( të ciklit të dytë) të sistemit të mësimimit dhe formimit ato që kanë kaluar provimin e Shtetit përfundimtar të ciklit të parë dhe që kanë marrë diplomën përkatëse.

Gati të gjitha institutet e mesme ndahen në një dyvjeçar dhe një trevjeçar. Dyvjeçari frekuentohet nga të rinj nga mosha 14 deri në 16 vjeç, trevjeçari nga të rinj nga mosha 16 deri në 19 vjeç. Çdo klasë është e përbërë nga djem dhe vajza.

Në shkollat e mesme kërkohet të paguhen taksa për rregjistrimit dhe frekuentimin; megjithatë, për studentët që rregjistrohen në vitin e parë dhe të dytë, këto institute, janë falas, nga momenti në të cilin dy vitet e para hyjnë në shkollën e detyrueshme. Disa shkolla parashikojnë taksa edhe për këto dy vite të fillimit.

Çmimet për blerjen e librave janë në ngarkim të familjeve. Edhe gjërat e nevojshme për shkollën (fletore, pena, ngjyra , etj.) duhet të blihen nga nxënësi.

Keni mundësi që të merrni një kontribut në para nën formën e çekut o të bursave të studimit për të blerë librat ndihmës mësimorë, për aktivitete mësimore, udhëtime mësimore dhe lehtësime në pagesën e shërbimit të transportit dhe të mensës. Është e nevojshme të plotësoni kërkesën që shpërndahet nga Komuna ose shkollat dhe formularin ISEE për çertifikimin e të ardhurave.

*Nxënësit me vështirësi ekonomike mund të marrin hua librat për vitin shkollor.*

*Pyetni në sekretari nëse keni mundësi të merrni hua.*



## \* ZGJEDHJA PAS MOSHËS 14 VJEÇ

- ✓ Nëse je **14 vjeçar** e **ke diplomën** e shkollës tetëvjeçare italiane (shkollës së gradës së 1°) o një titull ekuivalent, mund të shkruhesh në një shkollë të mesme (shkollë të gradës së 2°)
- ✓ Nëse je **14 vjeçar** por **nuk ke diplomën** e shkollës tetëvjeçare, mund të shkruhesh në shkollën tetëvjeçare për të marrë diplomën
- ✓ Nëse je **15 vjeçar** (ose më i madh) dhe **me diplomë** të shkollës tetëvjeçare italiane ose një titull ekuivalent:
  - Mund të shkruhesh në shkollën e mesme
  - Mund të shkruhesh në një kurs të përgatitjes profesionale
  - Sapo të mbushësh 16 vjeç, mund të frekuentosh në të njëjtën kohë një kurs në C.T.P. (qendra territoriale e përhershme) për të mësuar italishten
- ✓ Nëse je **15 vjeçar** por **nuk ke diplomën** e shkollës tetëvjeçare italiane:
  - Nëse ke frekuentuar të paktën 9 vjet shkollë në vendin tënd, mund të rregjistrohesh në shkollën e **mesme**,
  - **Mund** të shkruhesh në një kurs të përgatitjes profesionale
  - Sapo të mbushësh 16 vjeç, mund të frekuentosh në të njëjtën kohë një kurs në C.T.P. (qendra territoriale e përhershme) për të mësuar italishten dhe për të marrë diplomën e tetëvjeçares.

## \* CILËN SHKOLLË DYTËSORE

Në Itali ka tipe të ndryshme shkolle me shumë kurse dhe plane studimi.

Të gjitha kurset e studimit zgjasin 5 vjet dhe përfundojnë me një “provim shteti”. Nxënësit që kalojnë provimin marrin një “diplomë”. Pas diplomës mund të fillosh të punosh ose mund të vazhdosh studimet në Universitet.

Në institutet profesionale në fund të vitit të tretë bëhet një provim “kualifikimi”. Pas këtij provimi mund të fillosh të punosh ose mund të vazhdosh studimet për 2 vite të tjera dhe të marrësh diplomën përfundimtare. Kjo diplomë përfundimtare është një titull më komplet, i një niveli më të lartë dhe lejon të vazhdosh studimet në Universitet.

Përgatitja profesionale parashikon studime dy ose tre –vjeçare me marrjen e një kualifikimi profesional.




mosha

LICETÈ

INSTITUTE  
TEKNIKE

INSTITUTE  
PROFESIONALE

PERGATITJA  
PROFESIONALE



- ✓ **Studimi liceal 6 lice: klasik, shkenca, artistik, gjuhëve të huaja, muzikës dhe baletit, i shkencave humane**

Studentët që frekuentojnë licetë marrin një diplomë “pjekurije” por, në përgjithësi , parashikojnë të vazhdojnë studimet në universitet.

- ✓ **Studimi Teknik 2 sektorë: sektori ekonomik i ndarë në 2 degë, dhe sektori teknologjik, i ndarë në 9 degë**

Studentët që frekuentojnë kurse të ndryshme të studimit teknik marrin një diplomë që i jep mundësi të punojnë menjëherë në sektorin në të cilin janë specializuar, ose të vazhdojnë studimet në universitet.

- ✓ **Studimi profesional 2 sektorë: sektori i shërbimeve, i ndarë në 5 degë, dhe sektori i industrisë dhe artizanatit, që parashikon një degë**

Studimi profesional ka një plan studimi praktik, për të mësuar një zanat ose profesion. Pas 3 viteve të para studentët marrin një Diplomë Kualifikimi Profesional dhe fillojnë të punojnë. Duke vazhduar studimet për 2 vite të tjera marrin Diplomën e Studimit Dytësor në Degën Profesionale. Kjo diplomë jep më shumë mundësi për një punë të kualifikuar dhe jep mundësi për të vazhduar studimet në universitet.

- ✓ **Përgatitja profesionale**

Nëse do të frekuentosh një shkollë më të shkurtër ku ke mundësi të mësosh menjëherë një profesion mund të zgjedhësh ndërmjet kurseve të shumta të përgatitjes profesionale të autorizuara nga Krahina





## \* RREGJISTRIMI

Për t'u rregjistruar duhet të plotësoni një formular dhe të paraqisni dokumentat e kërkuara direkt në sekretarinë e shkollës:

### ✓ *Dokumentat anagrafike*

- letërnjoftimi
- kodi fiskal
- certifikata e lindjes
- akti i nënshtetësisë

### Ose autoçertifikimin e të dhënave të kërkuara

### ✓ *Dokumentat shëndetësore*

Shkolla kërkon një certifikatë me vaksinat e bëra. Në mungesë të këtij dokumenti nxënësit megjithatë mund të fillojnë shkollën. Familjet mund të drejtohen në ASL (ndërmarrje shëndetësore lokale,) për kontrollin e dokumentave ose për plotësimin e vaksinave.

### ✓ *Dokumentat shkollorë*

Shkolla kërkon një dokument të studimeve të kryera në vendin e lindjes, të përkthyer në gjuhë italiane.

Në pritje të dokumentit prindërit deklarojnë dhe autoçertifikojnë klasën dhe tipin e shkollës së frekuentuar në vendin e lindjes.

## \* ORARI

Në këtë nivel studimi, orari vendoset në bazë javore; oraret ndryshojnë në bazë të numrit dhe lëndëve të parashikuara nga kurset e studimit të degëve të ndryshme dhe orarit të mësimit që i është rezervuar.

Mësimi , i detyrueshëm, fillon rreth orës 8 të mjesit dhe mbaron rreth orës 13,30 . Disa shkolla kanë mësim edhe pasdite. Disa shkolla organizojnë pasdite aktivitete dhe kurse ndihmëse.

Është e rëndësishme të jeni të përpiktë

Informohuni menjëherë mbi oraret e klasës së fëmijës suaj dhe aktiviteteve të paraqitura



### \* **KALENDARI SHKOLLOR**

Viti shkollor zgjat nëntë muaj. Mësimi fillon në gjysmën e parë të shtatorit dhe mbaron brenda dhjetë ditëve të para të qershorit. Ka periudha pushimesh të vendosura përpara:

- ✓ Pushimet për Krishtlindje;
- ✓ Pushimet për Pashkë;
- ✓ Festa civile o fetare.

### \* **MUNGESAT NGA SHKOLLA**

Mungesat, vonesat ose daljet para orarit nga shkolla duhet të justifikohen nga prindërit në librezën shkollore.

### \* **LËNDËT E STUDIMIT**

Lëndët bazë, që janë të përbashkëta për të gjitha shkollat, janë: italishtja, historia, matematika, gjuha e huaj.

Çdo shkollë, përveç lëndëve të detyrueshme, i propozon nxënësve projekte me aktivitete të tjera.

Projekte të tilla mund të zhvillohen në mjes ose pasdite. Bashkësia e këtyre projekteve quhet *Plan i Ofertës Formuese( Përgatitore) (P.O.F.)*.

Parashikohen eksperinca formimi / punë (e papaguar) jashtë shkolle, të quajtura “stazhe e tirocini”.

Shkollat organizojnë shpesh vizita mësimore (muzeume, ekspozita, teatër, etj.) dhe udhëtime mësimore.

### **Mësimi i fesë katolike është fakoltativ.**

### \* **MËSIMI I FESË KATOLIKE O ZGJEDHJE ALTERNATIVE**

Në shkollën italiane parashikohet mësimi fakultativ i fesë katolike. Në momentin e rregjistrimit prindi mund të zgjedhë:

- ✓ Të përfitojë ose jo nga mësimi i fesë katolike
- ✓ Aktivitete didaktike dhe përgatitore në grup
- ✓ Aktivitete studimi ose kërkimi individual me ndihmën e një mësuesi
- ✓ Dalje nga shkolla



## \* SI VLERËSOHEN REZULTATET SHKOLLORE

Vlerësimi i mësimit dhe sjelljes së studentëve bëhet çdo tremujaj ose katërmujaj mbi bazën e rezultateve të arritura nga studenti gjatë vitit në forma të ndryshme verifikimi; vlerësimi bëhet nga Këshilli i klasës, dhe shprehet në pikë dhjetore, pozitive nga 6 në 10 e negative nga 0 në 5.

Për të kaluar në vitin e mëtejshëm, është e nevojshme të merret një notë e barabartë ose superiore me 6/10 në sejcilën lëndë dhe në sjellje. Nëse nota në një ose më tepër lëndë është më e ulët, pezullohet kalimi dhe studenti duhet të rekuperojë boshllëqet para fillimit të vitit shkollor të mëtejshëm. Nëse studenti merr notë të mjaftueshme në provimin para fillimit të vitit shkollor, kalohet në vitin e mëtejshëm.

Në fund të shkollës së mesme, si të asaj të përgjithshme ashtu edhe teknike e profesionale, nxënësit mbrojnë një provim Shteti për të marrë certifikatën e fundit të studimeve të shkollës së mesme.

Për të hyrë në provimin e Shtetit është e nevojshme që mesatarja e notave të marra në të gjitha lëndët, duke përfshirë edhe sjelljen, dhe nota në sjellje të jenë të barabarta ose superiore me 6/10.

Në institutet profesionale dhe në institutet e arteve, studentët mbrojnë një kualifikim të parë pas tre viteve të kursit, të cilëve i shtohen dy vite të tjera studimi të mëtejshëm për të marrë një kualifikim të nivelit të dytë të shkollës së mesme.

*Gjatë katërmujorit ka kontrole në klasë që shërbejnë për të dhënë vlerësimin e katërmujorit të 1° dhe të 2°.*

## \* MBLEDHJET NDËRMJET PRINDËRVE DHE MËSUESVE

Gjatë vitit shkollor organizohen disa mbledhje klase ndërmjet prindërve dhe mësuesve. Këto janë raste shumë të rëndësishme për të folur së bashku dhe për të njohur më mirë programin e studimit. Prindërit dhe mësuesit mund të bashkëpunojnë për edukimin e fëmijëve dhe hyrjen e tyre në shoqëri.

## \* BASHKËBISEDIME

Mësuesit në mënyrë periodike takojnë prindërit për të folur me ta mbi programin e klasës, mbi fëmijët, mbi vështirësitë dhe përparimin e tyre.

Çdo mësues njofton prindërit mbi ditën në të cilën mund t'i takojë për të folur.

Edhe prindërit mund të kërkojnë një bashkëbisedim me mësuesit.

*Nëse doni të flisni mbi fëmijën tuaj, kërkonijë menjëherë një takim me profesorin/shen*